

Më
Dana

05.02.2019

16-01-2018

C.nr.1003/18

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtarja Mirlinda Bytyqi-Rexhepi, në çështjen juridike të paditësit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] K.Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson [REDAKTUAR] avokat nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna Ferizaj- Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson [REDAKTUAR] në çështjen juridike kontestimore pagesa e pagave përcjellëse dhe jubilarë në prezencën e të autorizuarit të paditësit dhe të autorizuarit të paditurës, në shqyrtimin e mbajtur me datë 24.12.2018 merr, ndërsa me dt.03.01.2019 përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

- I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] K. Ferizaj si e bazuar
- II. DETYROHET, e paditura Komuna e Ferizaj- Drejtoria e Arsimit, që paditësit në emër të tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe një page jubilarë ti paguaj shumën e përgjithshme prej 1.494.28 € (një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër euro e njëzet e tetë cent), dhe atë shumën në lartësi prej 1.284.24 € për tri paga përcjellëse, dhe një pagë jubilarë në vlerë të një page bazë në lartësi prej 214.04 €.
- III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesë padisë përtej asaj që është vendosur si në pikën II të dispozitivit në shumën prej 107.04 € si e pa bazuar.
- IV. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia paguaj shumën si në pikën II të dispozitivit në 1.494.28 € (një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër euro e njëzet e tetë cent), me kamatën në lartësi prej 8%, duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë dt.17.10.2018 e deri në pagesën definitive, si dhe të paguaj shpenzimet e kësaj procedurë në shumë prej 269 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.



Arsyetimi

Paditësi [REDACTED] nga fshati [REDACTED] K. Ferizaj, përmes përfaqësuesit të tij [REDACTED] avokat nga Ferizaj me datë 17.10.2018 ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Ferizaj- Drejtoria e Arsimit në çështjen juridike pagesa e pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe pagës jubilarë.

I autorizuari i paditësit në seancën e mbajtur ka theksuar se mbetet në tërësi pranë kërkesëpadiisë dhe ka deklaruar se kërkon nga Gjykata që ta detyrojë të paditurën komuna e Ferizajt- Drejtorinë e Arsimit në Ferizaj që paditësit në emër të pagave përcjellëse pas pensionimit të ia paguaj shumën e të hollave prej 1.284.24 €, kurse sa i përket pagës jubilarë konstatojmë të paguaj shumën prej 214 €, pra tia paguaj paditësit shumën e përgjithshme 1.605.32 €.

I kërkon shpenzimet e procedurës për seancë gjyqësore, hartimin e padisë si dhe taksën për padi.

I autorizuari i të paditurës ka deklaruar se mbetet në tersi si në përgjigje në padi, duke e kundërshtuar në tersi kërkesëpadiinë e paditësit si të pabazuar ngase në bazë të dhënave të listave të pagës konstatohet se paditësit për muajin qershor, korrik dhe gusht 2018 ka realizuar pagën prej 428.80 € pra në shumën totale prej 1.284.24 €, kurse sa i përket pagës jubilarë konstatojmë se paditësi 10 vjetorin e ka arritur 7 viteve, nga kjo rezulton se me kohën e arritjes se këtij përvjetori kjo kontratë kolektive nuk ka qenë në fuqi dhe në asnjë dispozitë të kësaj kontrate nuk parashihet pagesa në mënyrë retroaktive paditësi gjithsejtë ka 17 vite përvojë pune.

Nga të gjitha provat e administruara sa i përket pagës jubilarë mendojmë se ekziston instituti i parashkrimit dhe njëkohësisht mendojmë që është kërkesë e parakohshme se pagat jubilarë në bazë të nenit 35 pika 8 pika 6 shpërblimin jubilar ipen në rastin e 7 Marsit ditën e mësuesit, njëkohësisht konstatojmë se paga bazë e mësimeve në shkollat fillore është 405 euro nga kjo bazë i kundërshtojmë edhe pretendimet e palës padisë sa i përket pagës jubilarë .

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve të çështjes kontestimore, për aq sa palët ndërgjygjëse përmbushin detyrimin e tyre për ti a parashtruar ato, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, ka administruar provat si vijon: *Padia C. nr. 1003/18 e datës 17.10.2018, përgjigja në padi e datës 14.11.2018, kontrata e punës për paditësin me nr.04/15 dt.18.11.2011, vërtetimi për përvojën e punës nga Sh.M.U "Muharrem Shemsedini" nr.protokoli 620 dt.15.10.2018, vërtetimi nga Sh.M.U "Muharrem Shemsedini" nr.protokoli 612 dt.12.09.2018, vërtetimi nga Sh.M.U" Dardania" Rakaj dt.17.07.2018, vendimi për pensionimin për paditësit e dt.10.08.2018, vërtetimi nga Komuna e Kaçanikut dt.03.08.2018.*

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk është kontestuese në mesë palëve se paditësi për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension.

Me leximin e vërtetimit të lëshuar nga SHMU 'Muharrem Shemsedini' në Ferizaj nr.protokoli 620 dt.15.10.2018 vërtetohet se paditësi i ka 6 vite e 11 muaj e 30 dite përvojë pune, vërtetimi nga Sh.M.U "Muharrem Shemsedini" nr.protokoli 612 dt.12.09.2018 vërtetohet se paditësi i ka 7 vite e 3 muaj e 16 ditë përvojë pune, vërtetimi nga Sh.M.U" Dardania" Rakaj dt.17.07.2018, vërtetohet se paditësi i ka 3 vite e 7 muaj e 23 ditë përvojë pune, me anën e të cilave gjykata ka konstatuar se paditësi ka përvojë të punës mbi 17 vite, të cilin fakt nuk e konteston as e paditura, me leximin e listave të pagave për muajt qershor, korrik dhe gusht gjykata ka konstatuar se paditësi në tre muajt e fundit ka realizuar mesatare e pagës në shumë prej 428.08 €.

Gjykata me rastin e përcaktimit të lartësisë për pagën jubilarë në shumën prej 214.04 €, si dhe tri pagave përcjellëse shumën prej 1.284.24 €, e ka marrë për bazë listat e pagave për muajt qershor, korrik dhe gusht, ku vërtetohet se paditësi në muajt e fundit para daljes në pension dhe se mesatarja e pagave mujore e tij ka qenë 428.08 €, kurse sa i përket pagës jubilarë pas administrimit të provave dhe deklarata e të paditurës është vërtetuar se paditësi ka përvojë të punës 17 vite, dhe sipas kontratës kolektive neni 8 pika 8.1 përcakton se për 10 vite përvojë pune i takon një pagë jubilarë në vlerë 50 % të një page bazë.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në faktin se me kontratën kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimin i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 49 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditësi e ka shfrytëzuar një të drejtë pasi që i njëjti përfiton nga kjo kontrate për faktin se me rastin e daljes së saj në pension kontrata kolektive ka qenë në fuqi e cila nuk është kontestuar nga ana e të paditurës.

Në nenin 35 par. 8 pika 1, 2, 3, 4, 5, të kontratës kolektive për të punësuarit në arsimin fillor dhe të mesëm është përcaktuar që punëtori ka të drejtë në shpërblim jubilar për 10 vite të përvojës në punë te punëdhënësi, i fundit në vlerë të 50 % të një page bazë, për 20 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë të 75 % të një page bazë, për 30 vite të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë të një page bazë, dhe për 40 vite të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë 150 %, të një page bazë, punëdhënësi i fundit është ai që e paguan shpërblimin jubilar, shpërblimi jubilar paguhet në afat prej 1 muaji pas plotësimit të kushteve nga kjo pikë, çka do të thotë se e paditura është dashur që me rastin e daljes në pension paditësit brenda 1 muaji sipas nenit 35 par. 8 pika 9.5 të ia paguajë pagën jubilarë pasi që i ka plotësuar këto kushte, pasi ka pasur përvojën e punës mbi 17 vjeçare dhe ka qenë obligim i të paditurës që të bëjë pagesën pa pasur nevojë as për të paraqitur ndonjë kërkesë çoftë gojore apo me shkrim të paditurës.

Kurse neni 35 par. 9 të Kontratës kolektive për të punësuarit në arsim fillor dhe të mesëm në Kosovë, është përcaktuar se punëtori ka të drejtë që me rastin e pensionimit në pagesat përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit, e në rastin konkret Gjykata ka marr parasysh që tri pagat e fundit të punëmarrësit kanë qenë 428.08 € në tre muajt e fundit para daljes në pension dhe me rastin e vendosjes meqenëse ka pasur ndryshime në listat e pagave për muajin qershor sepse paditësi ka arritur moshën e pensionimit me datë 10.08.2018, prandaj i ka marrë për bazë dy pagat e fundit që në rastin konkret rezulton se paditësi ka pasur mesataren e pagës mujore tek e paditura shumë prej 428.08 €.

Gjykata sa i përket refuzimit të pjesë tjetër të kërkesëpadisë e ka refuzuar pasi që me kontratën kolektive në nenin 35 par.8, e cila ka hyrë në fuqi me datën 18.04.2017, pas administrimit të provave dhe deklarata e të paditurës është vërtetuar se paditësi ka përvojë të punës mbi 17 vite, dhe sipas kontratës kolektive neni 8 pika 8.1 përcakton se për 10 vite përvojë pune i takon në vlerë të 50% të pagës bazë që i bije shuma prej 214.04 €.

Pretendimet e përfaqësuesit të paditurës se paditësi kërkesën për kompensimin e pagave jubilarë është e parakohshme në kuptim të nenit 35 pika 8.1 dhe 8.6, gjykata ka konstatuar se nuk është kontestuese se kërkesa për shpërblimin jubilar paguhet me rastin e 7 marsit të çdo viti, mirëpo me qëllim të ekonomizimit të procedurës dhe mos shkaktimit të shpenzimeve me anë të paraqitjes së padisë së re, gjykata e ka aprovuar edhe pjesën e kërkesëpadisë sa i përket pagës jubilarë, ndërsa sa i përket pretendimit se kemi të bëjmë me institutin e parashkrimit pasi që kjo është rregulluar me dispozitat ligjore të ligjit të punës nr. Ligji 03/L-212 dhe çështja e parashkrimit është e rregulluar me nenin 87 dhe ky afat nuk mundet me u ndryshu me marrëveshje në mes të palëve, se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me zbatimin e institutit të parashkrimit është edhe për faktin se në nenin 35 par.8 pika 8.5, thuhet decidivisht se punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpenzimin jubilar, e që në rastin konkret rezulton se paditësi ka dal në pension tek e paditura dhe kjo ka për obligim që të i paguajë paditësit një page jubilarë.


Lidhur me shpenzimet e procedurës, Gjykata në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, ka obliguar të paditurën që t'ia kompensoj shumën prej 269 €, për përpilim të padisë shumën prej 104.00 €, për një seanca të mbajtur shumën prej 135€, dhe taksën gjyqësore për padi në shumë prej 30€.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL

C.nr.1003/18 date 03.01.2019

Gjyqtarja
Mirlinda Bytyqi-Rexhepi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankësa në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të kopjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.